

# SISTEMI I PAGESAVE



# P ë r m b a j t j a

Ç'ËSHTË NJË PAGESË?	5
SI TË ZGJEDHIM NJË INSTRUMENT PAGESE?	12
INSTRUMENTET LETËR	13
INSTRUMENTET ELEKTRONIKE	14
SISTEMI I PAGESAVE	16
Ç'POZICION ZË BANKA E SHQIPËRISË NË SISTEMIN SHQIPTAR TË PAGESAVE?	19

USHQIME  
KREDI PËR SHTËPI  
KREDI PËR MAKINË  
RESTORANT  
QIRA  
PAGA



# Ç'ËSHTE NJË PAGESË?

Një pagesë është një transferim i vlerave monetare nga blerësi/urdhëruesi i shërbimit tek shitësi/përfituesi i shërbimit.

Nëse na pyesin “Për çfarë mendoni ju, kur thoni “pagesë”?” - si do të përgjigjeshim? Për shumicën nga ne, ajo çka na vjen në mendje, janë shembujt nga jeta jonë e përditshme: pagesa për ushqimet, pagesa e kësteve të kredisë për shtëpinë, të kredisë për makinën, pagesa për një darkë në restorant, pagesa e qirasë ose marrja e pagës. Dhe, kur mendojmë se si bëhen këto pagesa, na vijnë para syve pamjet e kartëmonedhave e të monedhave, të çekut, të kartave të kreditit ose ndoshta një depozitim në llogari.

Ajo çka nuk na shkon gjithmonë në mendje, janë hapat që ndodhin prapa këtyre skenave. Çdo pagesë që bëhet, pra çdo transferim vlere për shembull, nga ju tek i zoti i shtëpisë tuaj ose nga punëdhënësi juaj tek ju, përmban në vetvete një numër hapash. Këta hapa sigurojnë që pagesat të kryhen ashtu siç duhet. “Pa prit pak, - do të thoni ju, - kur unë paguaj me para në dorë në dyqan, nuk ka asnjë hap të ndërlikuar. Unë i jap paratë shitësit dhe ai më jep ushqimet”.


Kjo duket një vërejtje me vend. Por, ndryshe nga ç'mund të ngjajë në pamje të parë edhe këto pagesa të thjeshta në cash\*, mbështeten nga një sistem jo pak i ndërlikuar, që përfshin shumë hallka siç janë pajisjet e kontrollit antifalsifikim, mjetet e transportimit dhe të shpërndarjes së parave, makinat përpunuese e sortuese dhe elemente të tjera të cilat, të gjitha së bashku bëjnë të mundur që cashi të jetë një mjet i besueshëm shkëmbimi vlerash.

---

\* Cash – Paraja fizike, kartëmonedha dhe monedha metalike.

Le të marrim një shembull tjetër. Të përdorësh një çek duket diçka e thjeshtë. Ta zëmë se në fillim të çdo muaji ne plotësojmë një çek për pagesën e qirasë, duke shkruar mbi të emrin e qiradhënësit tonë dhe shumën e qirasë që i detyrohemi. Pastaj e nënshkruajmë atë, ia dorëzojmë qiradhënësit dhe disa ditë më vonë, kjo shumë rezulton e zbritur nga llogaria jonë rrjedhëse.

Por çfarë do të gjenim, nëse do të shikonim pas kësaj pamjeje të parë? Le të ndjekim skemën e mëposhtme:




Fillimisht, qiradhënësi juaj i jep çekun bankës së tij, Bankës A. Pastaj Banka A dërgon çekun në bankën tuaj, Banka B dhe, një kërkesë për pagesë në Bankën Qendrore, e cila luan rolin e ndërmjetësit. Banka Qendrore bën rregullimin në llogaritë e të dyja bankave, duke debituar llogarinë e Bankës B dhe duke kredituar llogarinë e Bankës A. Pas kësaj, Banka B, zbret shumën e qirasë nga llogaria juaj, ndërsa Banka A i bën fondet të disponueshme në llogarinë e qiradhënësit dhe kështu, pagesa është përfunduar.

Ajanëtë gjithë këta hapavërtetë nevojshëm? Pa dyshim, që janë! Kujtoni që një pagesë ishte një transferim vlerash. Kështu që, megjithëse mund të duket e kundërta, një çek nuk është në fakt një pagesë. Në të vërtetë, një çek përfaqëson një kërkesë për pagesë. Ne i kërkojmë bankës tonë të bëjë një transferim parash nga llogaria jonë në llogarinë e qiradhënësit. Hapat e mësipërm janë ata që bëjnë të mundur ekzekutimin faktik të pagesës.

Le të marrim shembullin e një mënyre tjetër pagese. Supozojmë se për të paguar qiranë, ju nuk lëshoni një çek por plotësoni



një urdhërpagesë. Ky është një formular i gatshëm, të cilin juaj në dispozicion bankë juaj, Banka B. Ju plotësoni në të, numrin e llogarisë tuaj dhe të qiradhënësit tuaj si dhe shumën e qirasë. Pasi e nënshkruani, e dorëzoni atë në bankën tuaj. Si është skema e lëvizjes së pagesës në këtë rast? Le të shohim skicën e mëposhtme:





Pas dorëzimit të urdhërpagesës në bankë, Banka juaj, Banka B dërgon një instruksion elektronik pagese në Bankën A (banka e qiradhënësit) nëpërmjet Bankës Qendrore, e cila është në rolin e ndërmjetësit. Banka Qendrore kryen rregullimet në llogaritë e të dyja bankave dhe Banka A, pasi merr konfirmimin për disponueshmërinë e fondeve, krediton llogarinë e qiradhënësit tuaj, ndërsa Banka B zbret shumën e caktuar nga llogaria juaj.

Siç shihet edhe me këtë mënyrë, pagesa përfundon pas kalimit në një numër të caktuar hallkash, të cilat janë të domosdoshme për ta bërë të besueshëm këtë transferim vlerash.

Hapat e përfshirë në kryerjen e një pagese, mund të ndahen në dy kategori: Ata që ndihmojnë në klerimin – procesi i transmetimit, shkëmbimit dhe në disa raste, i konfirmimit të kërkesave të pagesës – dhe në ata, që ndihmojnë në shlyerjen – hapi i fundit, i pakthyeshëm, i transferimit të pronësisë që përbën pagesën. Në shembullin e çekut, klerimi është lëvizja e çekut nga institucioni depozitues, Banka A, për në bankën për të cilën ai ishte shkruar, Banka B. Shlyerja është pakësimi i shumës së qirasë nga llogaria juaj dhe shtimi i llogarisë së qiradhënësit tuaj.

A ka mënyra të tjera pagese *jo cash*? Sigurisht që, po! Në rastin e pagesës së qirasë me çek, do t'ju duhet që të takoni çdo muaj qiradhënësin tuaj dhe t'i dorëzoni atij çekun; ndërsa në rastin e urdhërpagesës, do t'ju duhet të kaloni në bankë për ta plotësuar e dorëzuar. Ekziston një mënyrë më e thjeshtë dhe më komode për të kryer këtë pagesë. Ju mund t'i jepni bankës tuaj një urdhër për pagesë periodike, me anën e të cilit e autorizoni të kryejë në një datë caktuar të çdo muaji, pagesën për qiradhënësin, duke debituar për këtë llogarinë tuaj. Skema e lëvizjes së pagesës do të ishte e njëjtë me atë të urdhërpagesës që pamë më lart, duke eliminuar Hapin 1, pasi në këtë rast, banka juaj “do të kujtohej” vetë për kryerjen e pagesës së qirasë në datën e caktuar.

Pagesa periodike është një mënyrë mjaft e përshtatshme për të paguar një detyrim mujor me një shumë fikse, siç është qiraja, kësti i kredisë apo mirëmbajtja e ashensorit. Por, kjo mënyrë

nuk mund të përdoret kur na duhet të bëjmë një pagesë periodike, me një shumë jofikse. Për shembull, pagesa e faturës së energjisë elektrike, ujit, telefonit apo e celularit. Mënyra që mund të përdorim në këtë rast është urdhri për debitim direkt. Si funksionon ai?

Ju duhet të paguani çdo muaj faturën e telefonit celular. Kompania e telefonisë celulare ju kërkon që t'i jepni një autorizim për debitim direkt, duke nënshkruar një formular të posaçëm,



në të cilin ju shënoni emrin e bankës tuaj dhe numrin tuaj të llogarisë. Në çdo muaj, në datën e caktuar kompania dërgon faturën tuaj në bankën e saj, Banka A, e cila i kërkon bankës tuaj, Banka B, të pakësojë llogarinë tuaj me shumën përkatëse. Debitimi direkt është një instrument debiti dhe hapat e pagesës janë të ngjashëm me ata të çekut.

Sigurisht që, skema do të ishte më e thjeshtë, sikur llogaria juaj dhe ajo e qiradhënësit tuaj apo e kompanisë që kryen shërbimin për të cilin ju do të paguani, të ishte pranë të njëjtës bankë. Në këtë rast, pagesa do të përfundonte më shpejt dhe pa qenë nevoja e hallkës ndërmjetëse, Bankës së Shqipërisë.

Të gjitha këto mënyra pagese që pamë: *cash*, çeku, urdhërpagesa, pagesa periodike, debitimi direkt njihen si instrumente pagese.



# SI TË ZGJEDHIM NJË INSTRUMENT PAGESE?

Zgjedhja e një instrumenti pagese varet nga përgjigjja e një sërë pyetjeve lidhur me llojin e pagesës:

- E kam shitësin ballë për ballë (si në një dyqan) apo ai është diku tjetër?
- A duhet ta paguaj rregullisht (çdo muaj, javë) apo vetëm një herë?
- A duhet që ai t'i marrë paratë urgjent (brenda ditës) apo jo?
- A është një pagesë me vlerë të madhe apo me vlerë të vogël?
- Është një pagesë për brenda apo jashtë vendit?
- Sa kushton përdorimi i këtij instrumenti pagese?

Kombinimi i këtyre përgjigjeve do të na çonte në zgjedhjen e duhur. Sigurisht është më komode të paguajmë me *cash* në dyqan, ku e kemi shitësin përballë, por nuk është e përshtatshme kjo mënyrë për të paguar qiradhënësin, i cili banon diku larg. Mund të jetë e përshtatshme të paguajmë me *cash*, kur vlera e mallit që blejmë është e vogël, por nuk është aspak e volitshme të paguajmë me *cash* një ... apartament!

*Cashi* është një instrument i lirë dhe i pranueshëm nga të gjithë, por përdorimi i tij përmban shumë rreziqe, siç janë ai i falsifikimit, i vjedhjes dhe kosto mbajtjeje dhe transporti.

Përdorimi i instrumenteve *nocash* të pagesës i pakëson mjaft nga këto rreziqe, pasi siç e përshkruam edhe më lart, ekzistojnë një numër hallkash kontrolli që sigurojnë besueshmërinë e instrumentit.

# INSTRUMENTET LETËR

Çeku, urdhërpagesa, janë instrumente tradicionale pagese. Ato ndryshojnë nga forma, elementet e sigurisë, nga formati apo nga informacioni që përmbajnë si dhe drejtimi i lëvizjes.

Dallimi thelbësor midis një çeku dhe një urdhërpagese është se çeku është një instrument debiti, ndërsa urdhërpagesa është instrument krediti.

Në një instrument krediti, urdhëruesi (ju) i jep instruksione drejtpërdrejt bankës së tij (Banka B) për të transferuar fonde në bankën e përfituesit (qiradhënësit).

Në rastin e një instrumenti debiti, urdhëruesi (ju) i jep paraprakisht të gjitha instruksionet vetë përfituesit (qiradhënësit), i cili i kalon ato në bankën e tij (Banka A). Kjo e fundit ia kalon ato bankës së urdhëruesit (Banka B).

Pra në një transfertë krediti, instruksionet dhe fondet lëvizin në të njëjtin drejtim; kurse në një transfertë debiti, ato lëvizin në drejtime të kundërta.



# INSTRUMENTET ELEKTRONIKE

Instrumentet elektronike janë instrumente relativisht të reja në shërbimet e pagesave elektronike. Mjaft të përhapura në ekonomitë e zhvilluara janë kartat bankare (plastike). Në qoftë se ju zotëroni një kartë dhe dëshironi të tërhiqni para nga llogaria juaj jashtë banke, në aparate automatike, të cilat quhen ATM (*Automated Teller Machine*) karta juaj është kartë *cash*. Por, kur ju kërkoni që me anë të kartës të keni akses në llogarinë tuaj edhe për të kryer blerje dhe shërbime me fondet e disponueshme në këtë llogari në pika shitjeje POS (*Point-Of-Sale*), dyqane e restorante, atëherë karta juaj është kartë debiti. Me anë të kësaj karte bëhet i mundur debitimi automatik i llogarisë së kartëmbajtësit dhe kreditimi i shitësit. Ndërkohë që, kur ju përdorni fondet e bankës me një linjë krediti, ju keni mundësinë të bëni blerje, të kryeni pagesa dhe/ose të tërhiqni *cash* nën një kufi të paracaktuar, karta juaj është kartë krediti. Shumat e përdorura të kredisë, kartëmbajtësi i shlyen brenda një periudhe të përcaktuar më parë. Në mjaft raste të gjitha këto funksione ndërthuren edhe në një kartë të vetme.

Kartat e debitit kërkojnë një sistem *on-line* verifikimi dhe transmetimi të pagesës, ndërsa kartat e kreditit, mund të funksionojnë *off-line*. Kartëmbajtësi blen mallra apo shërbime dhe nënshkruan një dëftesë për shitësin duke i treguar atij edhe kartën e kreditit. Shitësi verifikon që, ky nënshkrim të jetë i njëjtë me nënshkrimin e shënuar mbi kartë. Pas kësaj, shitësi i dorëzon dëftesat në bankën e tij, e cila krediton llogarinë e shitësit dhe dërgon informacionin dhe kërkesën për pagesë në bankën e kartëmbajtësit.

Në ditët e sotme ju mund të përdorni dhe shërbime të tjera elektronike të realizuara si: *home banking*, *phone banking*, *internet banking* etj., që kryhen nëpërmjet mjeteve elektroteknike të komunikimit. Përdorimi i këtyre shërbimeve lidhet ngushtë me ekzistencën e infrastrukturës si dhe me aftësinë tuaj për të përdorur internetin dhe teknologjinë bashkëkohore. Nëpërmjet

këtyre shërbimeve, ju keni mundësi të kryeni pagesa, të shlyeni detyrimet mujore si dhe shërbime të tjera (të shihni gjendjen e llogarisë, pasqyrën e lëvizjeve në llogari, dërgimin dhe pranimin e informacioneve personale dhe të përgjithshme etj.) pa praninë tuaj fizike në bankë.

Kështu, kur dëshironi të kryeni shërbimet e mësipërme, duke përdorur internetin, banka ju ofron shërbimin *internet banking*. Ndërsa kryerja e po këtyre transaksioneve nga një llogari bankare duke përdorur telefonin, është një shërbim *phone banking*.

Kur përdorni kompjuterin tuaj me lidhje *online* me bankën, me anë të një linje telefonike pa përdorur internetin, për të realizuar transaksione të ndryshme bankare, përfshirë urdhërpagesat, shërbimi është *home banking*. Përdorimi i këtyre shërbimeve, ofron kushtet maksimale të sigurisë për të ruajtur fshehtësinë e të dhënave të klientit.

Zhvillimet teknologjike kanë nxjerrë në përdorim disa mjete pagese të quajtura “para elektronike” ose “e-money”. Paraja elektronike është zëvendësuese e kartëmonedhave dhe e monedhave, ruhet në një pajisje elektronike në formën e një karte *chip* apo memorie kompjuteri, emetohet në shkëmbim të një shume parash, e cila nuk mund të jetë më e ulët se vlera monetare e parasë elektronike të emtuar. Emetimi i parasë elektronike nuk është i lidhur domosdoshmërisht me ekzistencën e një llogarie bankare, si dhe ruan anonimitetin e blerësit gjatë përdorimit si instrument pagese.



# SISTEMI I PAGESAVE

*Sistemi i pagesave konsiston në një grup instrumentesh, procedurash bankare dhe sistemesh të transferimit të fondeve midis bankave, me qëllim qarkullimin e parasë brenda një hapësire të caktuar gjeografike, zakonisht një shteti.*

Në një sistem pagesash efektiv paratë arrijnë në kohën e duhur, në destinacionin e duhur dhe kështu ato mund të përdoren në mënyrë produktive për t'u investuar, për të kryer pagesa apo të tjera shërbime. Për të shmangur një bllokim të mundshëm në funksionimin e ekonomisë, pagesat duhet të lëvizin rrjedhshëm nga burimi në destinacionin e tyre. "Lubrifikanti" që lehtëson lëvizjen e pagesave është pikërisht sistemi i pagesave. Sistemi i pagesave siguron arteriet për zhvillimin e tregjeve dhe të aktiviteteve të tjera ekonomike në vend.

## PSE JANË TË RËNDËSISHME SISTEMET E PAGESAVE?

Ekziston gjithmonë rreziku që një pagesë të ndërpritet. Mendoni pak për rreziqet që përmbajnë pagesat që bëni: ju përpiqeni të paguani cash, por kartëmonedha juaj del falso. Ose ju përpiqeni të përdorni kartën e kreditit, por ajo rezulton e bllokuar. Ose ju paguani me çek, por mallrat tuaj nuk ju mbërrijnë kurrë. Secila metodë pagese përmban një numër rreziqesh, njohja e të cilave ndihmon në përcaktimin se si duhet të ndërtohen sistemet e pagesave. Duke siguruar shkëmbim të besueshëm dhe korrekt vlerash, masa sigurie dhe kryerje përfundimtare të pagesës, një sistem i mirë pagesash duhet të zbusë rreziqet që shoqërojnë çdo tip pagese.




Duke mbrojtur shkëmbimin e pagesave, sistemet e pagesave zvogëlojnë rrezikun për mospërfundimin e një pagese duke reduktuar kështu, humbjet e mundshme në ekonominë tonë.

## PAGESAT “ME RËNDËSI SISTEMIKE” KUNDREJT PAGESAVE “ME VLERË TË VOGËL”

Deri tani, ne u fokusuar vetëm në pagesat e përditshme të individëve apo të subjekteve tregtare që kryhen në tregun e mallrave dhe të shërbimeve. Këto pagesa janë individuale dhe kryesisht me vlera të vogla. Për këtë arsye, ato mund t’i quajmë “pagesa me vlerë të vogël” apo ndryshe “pagesa me pakicë”.

Përveç këtyre, ka edhe një kategori tjetër pagesash që mund t’i quajmë “pagesa me rëndësi sistemike”. Këto janë pagesa me vlerë të madhe, të cilat kryhen midis institucioneve financiare, tregtare ose qeveritare dhe zakonisht rrjedhin nga detyrimet e transaksioneve të tregjeve financiare. Në shembullin tonë të çekut për qiranë, thamë që Banka B detyrohet t’i shlyejë Bankës A shumën e çekut tonë. Njëkohësisht, ajo detyrohet t’i shlyejë edhe shumën e mjaft çeqeve të tjera që klientët e saj kanë lëshuar për klientët e Bankës A. Pra, pagesat tona “me pakicë” shndërrohen në një pagesë “me shumicë” që Banka B kryen për Bankën A. Shembuj të tjerë pagesash “me vlerë të madhe”, gjejmë në pagesat për këmbimet valutore, për transaksionet e tregut të parasë dhe për letrat me vlerë si, aksionet apo bonot e thesarit.

Diskutimi ynë për rrezikun bëhet edhe më me vend, në rastin e pagesave me vlerë të madhe. Krahasuar me pagesat “me pakicë”, rreziqet dhe humbjet e mundshme janë shumë më të mëdha në pagesat “me shumicë”. Ka dy shpjegime për këtë. Së pari, pagesat “me shumicë” janë zakonisht, në vlera shumë më të mëdha se ato “me pakicë”. Për më tepër, siç e përmendëm



më parë ato përdoren kryesisht në tregjet financiare. Mirëfunksionimi i këtyre tregjeve varet në mënyrë të konsiderueshme nga përfundimi i pagesës. Nëse lind ndonjë problem, atëherë për shkak të efektit tepër negativ që shkakton të qenurit zbuluar si dhe të faktit që pagesa është një element thelbësor në këtë proces, mundet që i tërë tregu financiar – i cili është shtylla kurrizore e ekonomive të sotme – të ndikohet negativisht. Si rrjedhim, sistemet e pagesave "me shumicë" luajnë një rol kyç në mbarëfunksionimin e ekonomisë së tregut.

Pra, shohim se identifikimi i rreziqeve është mjaft i rëndësishëm në një sistem pagesash. Për këtë arsye, bankat qendrore në të gjitha vendet marrin përsipër rolin e dizenjimit dhe të mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave. Ato duan të sigurohen që, strukturat dhe ndërtimi i këtyre sistemeve janë të përshtatshme për t'iu bërë të mundur pjesëmarrësve të administrojnë likuiditetet e tyre dhe të mos gjenerojnë rreziqe për tregjet financiare apo sistemet bankare kombëtare ose ndërkombëtare.

# Ç'POZICION ZË BANKA E SHQIPËRISË NË SISTEMIN SHQIPTAR TË PAGESAVE?

Banka e Shqipërisë ka si detyrë të përcaktuar nga ligji “Për Bankën e Shqipërisë”, nxitjen dhe mbështetjen e sistemit të pagesave. Prej kësaj, buron jo vetëm roli operacional e mbikëqyrës që Banka e Shqipërisë ka mbi sistemin shqiptar të pagesave por edhe ai reformativ dhe zhvillues i këtij sistemi.

## BANKA E SHQIPËRISË OFRON SHËRBIMIN E PAGESAVE PËR BANKAT.

Banka e Shqipërisë është një ndërmjetëse aktive në “klerimin” dhe “shlyerjen” e pagesave ndërbankare (kujtoni skemat e përshkruara më sipër). Ajo e luan këtë rol, pasi mban llogari në lekë për të gjitha bankat në Shqipëri. Kështu, ajo mund të shlyejë me lehtësi transaksionet e pagesave, duke debituar llogarinë e bankës që urdhëron pagesën dhe duke kredituar llogarinë e bankës që e përfiton atë. Për më tepër Banka e Shqipërisë si bankë qendrore, nuk ka probleme likuiditeti (mospasja e fondeve të mjaftueshme për të shlyer pagesat) apo probleme krediti kështu që pagesat e kryera në llogaritë në Bankën e Shqipërisë nuk përmbajnë rrezik mosshlyerjeje apo rrezik dështimi.

Banka e Shqipërisë u ofron shërbime pagese, bankave. Përveç shërbimeve të cashit (furnizimi, shpërndarja, grumbullimi e seleksionimi i monedhave dhe kartëmonedhave) ajo ofron

shërbime jocabashi siç janë: klerimi i çeqeve dhe i urdhërpagesave ndërbankare, shërbimet e shlyerjes neto si dhe shlyerja e pagesave me vlerë të madhe.

## BANKA E SHQIPËRISË DREJTON REFORMAT PËR MODERNIZIMIN E SISTEMIT TË PAGESAVE NË SHQIPËRI.

Për t'iu përgjigjur detyrimit të saj ligjor për nxitjen e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë ka marrë përsipër rolin udhëheqës për reformimin e sistemit shqiptar të pagesave.

Në këtë vështrim, Banka e Shqipërisë përpiqet të shkurtojë kohën midis *klerimit* dhe *shlyerjes* me qëllim që të minimizohet rreziku i mospërfundimit të pagesës.

Është veçanërisht e rëndësishme që në momentet e reformave të sistemeve që realizojnë kalimin nga një sistem i bazuar në letër, në transferimet elektronike të fondeve, të përcaktohen rregullat që administrojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në proceset e pagesave. Këta rregulla duhet të jenë parashikuar si për kushtet normale të punës, ashtu edhe për situatat jonormale.

Data 31 janar 2004 shënoi fillimin e operimit të Sistemit Shqiptar të Pagesave Ndërbankare me rëndësi sistemike "AIPS" (Albanian Interbank Payment System). Ky sistem përpunon pagesat që ne i quajmë "me rëndësi sistemike", pra pagesat me vlera të mëdha. Siç e thamë më lart, këto pagesa lindin nga transaksionet e tregjeve financiare (midis bankave apo institucioneve financiare). Nëpërmjet sistemit AIPS, ekzekutohet shlyerja vetëm e pagesave në monedhën kombëtare Lek (ALL).


## Ju do të pyesni se ku është i vendosur ky sistem?

Sistemi është i instaluar në Bankën e Shqipërisë. Pjesëmarrëse në sistem janë të gjitha bankat që ushtrojnë aktivitet brenda vendit dhe Banka e Shqipërisë. Kjo e fundit në rolin e pronarit dhe administratorit të sistemit mbikëqyr, organizon, administron dhe operon sistemin.

Banka e Shqipërisë është edhe vetë pjesëmarrëse e sistemit të pagesave. Ajo kryen nëpërmjet sistemit të pagesave, pagesa për qëllime të politikës monetare. Për më tepër, Banka e Shqipërisë kryen pagesa për llogari të klientëve të saj, siç është edhe detyrimi për të shlyer pagesat në sistem për llogari të Qeverisë Shqiptare.

## Si funksionon teknikisht sistemi AIPS?

Bankat i dërgojnë instruksione pagese njëra-tjetrës nëpërmjet shërbimit SWIFT (hapi 1). Ky shërbim bën të mundur që një pjesë e këtij mesazhi të kopjohet dhe të dërgohet në sistemin qendror AIPS (hapi 2). Në bazë të informacionit që merr nga kopja e mesazhit të transferuar elektronikisht, sistemi AIPS ekzekuton automatikisht shlyerjen e pagesës duke kaluar fondet nga llogaria e Bankës dërguese A tek llogaria e Bankës përfituese B, me kusht që Banka A ka fondet e mjaftueshme për të ekzekutuar pagesën. Në të kundërt, instruksioni i pagesës vendoset në rradhën e pritjes, deri në krijimin e fondeve të mjaftueshme në llogarinë e bankës dërguese. Pas shlyerjes së pagesës në sistemin AIPS, dërgohet konfirmimi në SWIFT (hapi 3) dhe në vijim tek Banka përfituese B (hapi 4), duke mbyllur ciklin e shlyerjes së pagesës. Me marrjen e konfirmimit me mesazh SWIFT, Banka përfituese B ka sigurinë që pagesa është shlyer dhe fondet kanë kaluar në llogarinë e saj në mënyrë të pakthyeshme dhe përfundimtare. Duke qenë plotësisht i automatizuar, sistemi e përfundon ekzekutimin e pagesës “në kohë reale”, që nënkupton brenda pak sekondash nëse dërguesi ka fondet e mjaftueshme në llogari.



Në qoftë se do të kujtojmë diskutimin tonë për rrezikun, më lart thamë që një nga mënyrat për shmangien e rrezikut është zvogëlimi i kohës midis dërgimit dhe shlyerjes së pagesës. Sistemi AIPS, këtë kohë e redukton pothuaj në zero dhe kështu, sistemi i pagesave ndërbankare me rëndësi sitemike shmang plotësisht ekzistencën e rreziqeve potenciale të mosshlyerjes.

**Sa kushtojnë transfertat për bankat dhe për klientët?**

Çmimi që një bankë duhet të paguajë për një pagesë në sistemin AIPS është 250 lekë, ndërsa pagesa vjetore për pjesëmarrjen në sistem është 350 mijë lekë. Këto tarifa janë plotësisht të

krahasueshme me ato të sistemeve të ngjashme në rajon dhe janë llogaritur të mbulojnë vetëm kostot operative të mirëmbajtjes dhe funksionimit të sistemit. Ndërkohë, kostot e investimit përballohen plotësisht nga Banka e Shqipërisë si një investim publik për reformën e sistemit të pagesave.

Çmimi për klientët e bankave që dëshirojnë të kryejnë pagesa nëpërmjet sistemit AIPS, përcaktohet nga vetë bankat sipas politikave të tyre të shërbimit ndaj klientit.

## Sa është shuma minimale dhe ajo maksimale që mund të transferohet?

AIPS nuk ka kufizime në vlerat e pagesave që mund të transferohen nëpërmjet tij. Bankat mund të dërgojnë për shlyerje pagesa në vlera të ndryshme. Megjithatë, sistemi AIPS është i dizenuar kryesisht për pagesat me vlera të mëdha. Bankat janë të detyruara që të kalojnë domosdoshmërisht për shlyerje në sistemin AIPS, pagesat me vlerë më të madhe se një vlerë e caktuar, aktualisht 1 milion lekë.

Sistemi AIPS hapet çdo ditë pune në orën 8:30. Ai shlyen pagesa për klientët deri në orën 15:00. Sistemi pranon shlyerje pagesash për transaksionet e tregut ndërbankar si dhe për transaksione të iniciuara nga Banka e Shqipërisë deri në orën 16:00. Sistemi fillon mbylljen e tij në orën 16:30.

## Çfarë të rejash ka sjellë ky sistem dhe çfarë ofron ai për bankat pjesëmarrëse ?

Në rradhë të parë, ky sistem zvogëlon në maksimum rrezikun e kreditit në pagesat ndërbankare, pasi siguron në mënyrë përfundimtare shlyerje të pakthyeshme të pagesës.

Sistemi u mundëson pjesëmarrësve në të, monitorimin dhe administrimin më të mirë të likuiditetit të tyre (sistemi siguron informacion në kohë reale për gjendjen e llogarisë, rezervat e lira, pagesat në pritje për t'u ekzekutuar). Pra, funksionimi i këtij sistemi nxit ndjeshëm tregun ndërbankar dhe eficiencën e tij. Kjo do të thotë më shumë përfitim për bankat dhe një përcim më efikas i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Gjithashtu, sistemi AIPS krijon mundësinë e kreditimit nga Banka e Shqipërisë për bankat, me qëllim plotësimin e nevojave të bankave për likuiditet brenda ditës dhe garantimin e vijueshmërisë normale të funksionimit të sistemit, në përputhje me vendimet dhe me objektivat e miratuar të politikës monetare.

Për të automatizuar procesin e shlyerjes së pagesave me vlerë të vogël apo me pakicë, Banka e Shqipërisë, në datën 8 korrik 2005 filloi operimin e Sistemit të Klerimit Automatik të Pagesave me Vlerë të Vogël "AECH" (Albanian Electronic Clearing House).

Sistemi AECH siguron klerimin e pagesave me vlerë të vogël ndërmjet bankave pjesëmarrëse në sistem, për t'u shlyer në vijim për vlerë neto në sistemin AIPS. Klerimi i pagesave realizohet në dy seanca gjatë një dite pune. Seanca e parë fillon në orën 8.30 dhe përfundon në orën 11.30, ndërsa e dyta fillon në orën 12.00 dhe përfundon në orën 15.00. Mbyllja e sistemit AECH realizohet në orën 15.30.

Gjatë një seance klerimi, bankat dërgojnë pagesa në sistem, të cilat klerohen menjëherë sipas bankave dërguese dhe pritëse. Në fund të seancës së klerimit, sistemi AECH përgatit një instruksion shlyerjeje për sistemin AIPS (ku gjenden llogaritë e bankave), i cili përmban rezultatin neto të klerimit të pagesave sipas bankave dërguese dhe pritëse. Pasi kryen shlyerjen e instruksionit, sistemi AIPS i kthen përgjigje sistemit AECH dhe të gjitha pagesat me vlerë të vogël të cilat u kleruan gjatë seancës së klerimit, konsiderohen të shlyera.





Sistemi AECH është dizenuar për kalimin e pagesave me vlerë të vogël, për shuma jo më të mëdha se 1 milion lekë. Sistemi përpunon dy tipe instruksionesh pagese: urdhërpagesë me vlerë të vogël (UPV) dhe debitim direkt (DD).

Çmimi që një bankë duhet të paguajë për të shlyer një urdhërpagesë me vlerë të vogël në sistemin AECH është vetëm 4 lekë dhe për debitimin direkt, vetëm 5 lekë. Tarifa mujore për pjesëmarrjen në sistem është 7,500 lekë. Çmimi për klientët e bankave që dëshirojnë të kryejnë pagesa nëpërmjet sistemit AECH, përcaktohet nga vetë bankat sipas politikave të tyre të shërbimit ndaj klientit.

Ashtu si edhe sistemi AIPS, vënia në funksionim e sistemit AECH ka sjellë përfitime të ndjeshme për sistemin financiar shqiptar, në drejtim të rritjes së shpejtësisë së kryerjes së pagesave të klientëve, uljes së kostove, rritjes së sigurisë në përpunimin e pagesave, përmirësimin e efektivitetit dhe kohës së mbledhjes së pagesave nga kompanitë utilitare, uljen e përdorimit të cashit si mjet primar pagese etj.. Sistemi mundëson monitorimin dhe administrimin më të mirë të likuiditetit nga Banka e Shqipërisë dhe bankat pjesëmarrëse në sistem.

Për sa i takon çeqeve ndërbankare, klerimi i tyre vazhdon të realizohet nëpërmjet shkëmbimit fizik në seancat e kleringut që zhvillohen çdo ditë në orën 13:00, në ambientet e Bankës së Shqipërisë.

Banka e Shqipërisë, me vënie në funksionim të dy sistemeve të pagesave, ka krijuar infrastrukturën bazë për modernizimin e mëtejshëm të sistemit të pagesave në veçanti dhe të sistemit financiar, në përgjithësi.

## Banka e Shqipërisë mbikëqyr sistemin shqiptar të pagesave.

Ligji i jep Bankës së Shqipërisë të drejtë të përcaktojë kuadrin rregullativ të sistemit, duke miratuar rregulla e procedura që janë të detyrueshme të zbatohen nga të gjithë pjesëmarrësit në sistem.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë është autoriteti që mbikëqyr dhe licencon institucionet pjesëmarrëse në sistemin e pagesave, bankat që emetojnë dhe ekzekutojnë instrumente pagese. Ajo, jo vetëm mbikëqyr veprimtarinë e këtyre pjesëmarrësve në fushën e pagesave, por edhe koordinon punën me pjesëmarrësit në sistem.

Nëpërmjet mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, Banka e Shqipërisë synon nxitjen dhe mbështetjen e mirëfunksionimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, veçanërisht me qëllim që të arrihet:

- a) stabiliteti dhe besueshmëria e sistemeve të pagesave, duke identifikuar, parandaluar dhe zgjidhur në kohë rreziqet potenciale, në mënyrë të veçantë rrezikun e kreditit, sistematik, ligjor, operacional dhe të likuiditetit;
- b) efektiviteti dhe efienca e sistemeve të pagesave, me synim që kostoja e shërbimeve që i ofrohen përdoruesve të reflektojnë në mënyrën e duhur vlerën e këtyre shërbimeve;
- c) transparenca në rregullat operacionalë të sistemeve të pagesave, si dhe të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në sistem dhe të përdoruesve;

- d) struktura e duhur administrative, operacionale dhe teknike për sistemet e pagesave;
- e) ruajtja e besimit të publikut në instrumentet e pagesave të përdorura dhe shërbimeve të pagesave të ofruara, në mënyrë të veçantë sa i takon shlyerjes së pagesave në kushte të përcaktuara (procedura, kohë ekzekutimi etj.), duke siguruar plotshmëri teknike dhe ligjore dhe parandalim efektiv të mashtrimeve;
- f) promovimi i automatizimit në përdorimin dhe procesimin e instrumenteve të pagesave si dhe ndëroperabiliteti i sistemeve mbështetëse.

Banka e Shqipërisë ka mundësi të influencojë në ndryshimet e sistemit nëpërmjet bindjes apo rolit të katalizatorit (diskutimit me pjesëmarrësit në sistem), publikimit të materialeve të ndryshme (dokumenti i politikës së mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave, fjalime të Guvernatorit dhe analiza të vlerësimit të sistemit), marrëveshjeve apo kontratave për pjesëmarrje në sistem, bashkëpunimit me autoritete të tjera si dhe të drejtës në ligj për të vepruar.

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në  
formë elektronike në adresën:

[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)

Në qoftë se dëshironi të keni kopje të shkruara  
të tij mund t'i kërkonit në adresën:

Banka e Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej"  
Nr.1 Tiranë, Shqipëri,

Tel.: +355-(0)4-2222152;

Faks: +355-(0)4-2223558

ose duke dërguar një e-mail në adresën:

[public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)

Tirazhi: 3000 kopje